



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:029155

Datë: 26.05.2021

Numri i dokumentit: 01816894

C.nr.102/2021

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtar Nuredin Abazi, me praktikanten Blenda Gashi, në çështjen juridike të paditësve Xh. D. B. nga fshati M., Komuna S., kundër të paditurit S. S. T. ish nga fshati M., Komuna S., tani me banim në S.-C. rruga L. 67b në Republikën e Serbisë, të cilin me autorizim e përfaqëson Av.D. F. nga S., me padi për vërtetim pronësie në bazë të pohimit, në seancën e mbajtur në praninë e paditësit dhe të autorizuarit të të paditurit, me dt. 20.05.2021 bie këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të pohimit

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Xh. D. B. nga fshati M., Komuna S.

II. VËRTETOHET se paditësi Xh. D. B., ka fituar të drejtën e pronësisë në parcelën kadastrale P-.... në sipërfaqe prej 2981 m², në vendin e quajtur “F.” Zona Kadastrale M., Komuna S.

III. Ky aktgjykim do të shërbej si provë për regjistrimin e paluajtshmërisë në emër të paditësit në librat kadastral komunal për ngastrën e lartshënuar.

IV. Shpenzimet e procedurës i bart paditësi.

A r s y e t i m

Paditësi Xh. D. B. nga fshati M., Komuna S., pranë kësaj Gjykate ka parashtruar padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, ndaj të paditurit S. S. T. ish nga fshati M., Komuna S., tani me banim në S.-C. rruga L. 67b në Republikën e Serbisë.

Paditësi Xh. D. B. në seancë ka deklaruar: mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, paluajtshmërinë lëndore P-.... në vendin e quajtur “F.” në sipërfaqe prej 2981m² ZK M. qysh në vitin 1983 e kam blerë nga i padituri S. S. T. sipas marrëveshjes verbale dhe lidhur me këtë shitblerje të gjitha të hollat ja kam dhënë sipas marrëveshjes dhe që nga atëherë kam hyrë në posedim të papenguar gjer në ditët e sotme, tani kërkoj nga gjykata që parcela në fjalë pas deklarimit të autorizuarit të të paditurit të regjistrohet në emër tim pasiqë lidhur me këtë shitblerje

nuk ka asgjë kontestuese mes meje dhe të paditurit. Pas deklarimit të të autorizuarit të paditurit i cili pohoi në tërësi kërkesëpadinë time deklarojë se heqi dorë nga e drejta e ankesës.

I autorizuari i të paditurit Av.D. F. nga S. në seancë ka deklaruar: mbi bazën e autorizimit të cilin e posedojë nga pala e paditur dhe në bazë të bisedes telefonik me të cilin jam dëgjuar mund të vërtetojë se shitblerja e ngastrës kadastrale me numër ZK M. është kryer sipas marrëveshjes gojore në vitin 1983 në mes të paditësit dhe xhaxhait të të paditurit Zh. T. kjo nga fakti se në kohën e kryerjes së shitblerjes i padituri me xhaxhain e tij kanë jetuar në një bashkësi familjare. Tani këtu bashkësinë familjare e kanë shkëputur dhe në bazë të kontratës të vërtetuar tek noteri M. Z. në Suharekë me numrin LRP.../2013 dhe numri Ref.198/2013 e njejta paluajtshmëri tani është regjistruar në emër të palës së paditur. Që nga atëherë pala paditëse është në posedim dhe që atëherë ka përmbush pagesën e çmimit të shitblerjes në tërësi. Kërkojmë që shpenzimet e procedurës t'i bart pala paditëse dhe nëse gjykata do ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e palës paditëse parapakisht heqim dorë nga e drejta e ankesës.

Gjykata në kuptim të nenit **7 dhe 8 të LPK-së** bëri shiqimin e provave dhe atë: në Çertifikatën e pronës për ngastrën kadastrale P-.... në sipërfaqe prej 2981 m² në vendin e quajtur "F." Zona Kadastrale M. Komuna S., e cila evidentohet në emër të të paditurit.

Gjykata pas leximit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, deklaratës së padiësit dhe deklaratës së të autorizuarit të të paditurit të dhëna në këtë procedurë, vendosi që të aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, pasi që edhe i autorizuari i të paditurit në seancë gjyqësore në tërësi e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësit.

Andaj, bazuar në nenin 148 të LPK-së Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata hoqi dyshimet që kanë të bëjnë me kërkesat e palëve të cilët nuk mund të disponojnë lirisht neni 3.3 të LPK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës u muarr në kuptim të nenit 452.3 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:029155, 20.05.2021, C.nr.102/2021

Praktikante
Blenda Gashi

G j y q t a r i
Nuredin Abazi

KËSHILLË JURIDIKE: Aktgjykimi është i plotfuqishëm ditën e publikimit pasi palët në seancë gjyqësore kanë hequr dorë nga e drejta e ankesë.